



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM SHKODËR

URDHËR

Nr. 15 datë 05.06.2023

**“PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE ADMINISTRATIVE/PROCEDURALE
PROKURORIT TË ÇËSHTJES”**

Në mbështetje të neneve 148, 148/b e vijues të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, si dhe në neneve 41, 42, 43, 44, 45, 52, 103 e vijues të Ligjit Nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neneve 24, 25, 99, 105, 110 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe duke pasur parasysh Vendimin e Këshillit të Ministrave me nr.226, datë 13.04.2023, “Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2023” dhe Udhëzimit të Përgjithshëm me nr.02, datë 12.05.2023, “Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe Udhëzimit të Përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë me nr.13, datë 29.05.2023, “Mbi zbatimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023, në prokurorinë pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Shkodër”, *me qëllim rritjen e pavarësië, rolit aktiv dhe përgjegjshmërisë së prokurorit.*

URDHËROJ:

1. Prokurorët në lidhje me të gjitha çështjet që ata kanë në hetim apo në gjykim, të administrojnë, marrin në shqyrtim dhe të kthejnë përgjigje kërkesave, shkresave, memove apo pretendimeve të palëve në proces, personit nën hetim/të pandehurit, avokatit të tij, viktimës/trashëgimatarëve të tij apo mbrojtësit, personave të tretë, subjekteve të tjera apo gjykatës, ku përgjigjet e këtyre kërkesave, shkresave, pretendimeve apo memove, nënshkruhen në emrin dhe nënshkrimin e tyre, **“ME URDHËR DHE DELEGIM”**, **“PROKURORI I ÇËSHTJES”**.
2. Përjashtohen nga ky urdhërim korrespondenca me institucionet shtetërore qendrore, si: Prokuroria e Përgjithshme, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektoriat i Lartë i Drejtësisë, Ministrinë, etj, si dhe për çështjet e përfunduara dhe të arkivuara, ku shkresat do të vijojnë të nënshkruhen nga Drejtuesi i Prokurorisë apo Zëvendësdrejtuesi i Prokurorisë.

3. Koordinatorja për të drejtën e informimit dhe oficeri i policisë gjyqësore i ngarkuar me hetimin e çështjes konkrete për të cilën kërkohet i informacion, ndihmojnë prokurorin e çështjes në përgatitjen e informacionit dhe hartimin e akteve sipas udhëzimit e orientimit të prokurorit të çështjes që do të nënshkruaj kthim-përgjigjen përkatëse.
4. Koordinatorja për të drejtën e informimit është përgjegjëse për mbajtjen e rregullt të regjistrit dhe korrespondencës për kthimin e përgjigjeve subjekteve të ndryshme kërkuese dhe merr masat e duhura për të sinjalizuar apo rikujtuar prokurorit të çështjes respektimin e afatit ligjor 15 ditor për kthimin e përgjigjeve, si dhe protokollon shkresat dhe mban kopje të tyre sipas datave dhe numrit të protokollit.
5. Me këtë urdhër dhe për zbatimin e tij të njihen të gjithë prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe administrata.
6. Moszbatimi i këtij urdhëri pasjell përgjegjësi ligjore sipas rastit.
7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTUESI I PROKURORISË

Albert MURÇAJ

